



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 153 / Prot.
4

Tiranë, më 16 /06/2017

VENDIM

Nr. 81 ,datë 16/6/2017

Në mbështetje të nenit 21, pika 1/b, 3 dhe 4 të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik",

VËREJ SE:

Ankuesi, Komitetit Shqiptar i Helsinkit (këtej e tutje K.SH.H) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 256 Prot., datë 04.05.2017, ndaj Organit Publik Ministrisë së Zhvillimit Urban (më tej, organi publik), me objekt "Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik për projektligjin "Për strehimin social".

Rezulton se ankesa është depozituar në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 21, pika 1/b të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", për shkak se projektakti është njoftuar i miratuar dhe si i tillë ankuesi legjitimohet në paraqitjen e saj në afat.

Gjithashtu, ankuesi legjitimohet edhe në ngritjen e objektit të kësaj ankese në përputhje me pikën 1/b të nenit 8 të ligjit 146/2014, në të cilën thuhet shprehimisht se, "...palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik janë shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit..." K.SH.H në zbatim të projektit "Për një Transparencë dhe pjesëmarrje më të lartë të grupeve të interesit në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse të organeve publike", konsiderohet grup interesi në lidhje me konsultimin publik.

- Sipas ankuesit, nga kërkimi në faqen zyrtare on-line të Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike nuk rezulton të jetë publikuar projektakti në fjalë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 7, madje organi publik nuk ka realizuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik me asnjë nga mënyrat e tjera të njoftimit dhe marrjes së komenteve dhe rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" (në vijim quajtur ligji për njoftimin dhe konsultimin publik).
- Sipas ankuesit dhe provave bashkëngjitur (printime të faqes zyrtare të MZHU mbi publikimin e disa projektakteve ligjore dhe nënligjore në kohën e konsultimit të tyre), mënyra e realizimit të njoftimit dhe konsultimit nëpërmjet dërgimit të emailit për disa grupe interesi, nuk garanton zbatimin e një procesi gjithëpërfshirës. Drafti i projektligjit është publikuar në

faqen e internetit të organi publik, por njoftimi i publikuar nuk përmbush kërkesat e përcaktuara nga ligji pasi nuk është cituar afati kohor brenda të cilit duhet të dërgohen komentet dhe sugjerimet e subjekteve të interesuara.

Pas vlerësimit të ankesës së K.SH.H në përputhje me pikën 3 të nenit 21 të ligjit nr.146/2014 në të cilin citohet se “...me marrjen e një ankese, Komisioneri i kërkon ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrimet me shkrim brenda 10 ditëve”, Komisioneri me shkresën Nr. 753/1 Prot., datë 09.05.2017, ka kërkuar nga organi publik të paraqesë parashtrime me shkrim brenda këtij afati.

Organi publik me shkresën Nr. 2843/1 Prot., datë 18.05.2017, lidhur me pretendimet për mos ndjekjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik parashikuar në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, parashtron se:

- Projektligji “Për strehimin social” është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në përputhje me ligjin 146/2014. Në datën 1 gusht 2016 është bërë publikimi i draftit të parë të projektligjit në adresën e email-it ligjistrehimit@zhvillimiurban.gov.al dhe ka qëndruar në adresën zyrtare të organit publik për 6 muaj.
- Gjatë muajit gusht 2016 drafti është dërguar për mendim 125 subjekteve, mes të cilave 61 bashkive të vendit, shoqatave/organizatave që operojnë në fushën e mbrojtjes së interesave të grupeve të pafavorizuara, të gjitha ministrive si dhe institucioneve të pavarura, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Një pjesë e këtyre subjekteve kanë dërguar mendime ose sugjerime ndërsa të tjerë kanë shprehur dakordësinë me projektligjin.
- Duke filluar nga muaji shtator 2016, janë analizuar dhe reflektuar komentet e ardhura dhe është hartuar drafti i dytë i projektligjit, i cili është diskutuar në takimet e zhvilluara në kuadër të konsultimit publik, konkretisht në Vlorë, Pogradec, Lezhë dhe Tiranë me prezencën e grupeve të pa favorizuara (PAK, jetim, komuniteti rom dhe egjiptian).
- Lidhur me pretendimin e mos publikimit të projektligjit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, informojmë se në kohën kur është zhvilluar faza e konsultimit, sistemi RENJK nuk ka qenë funksional, pasi prezantimi mbi funksionimin e këtij sistemi është bërë më datën 21.10.2016 në çorkshop-in “Improving the Public Consultation Process in Albania”. Gjithashtu me shkresën nr. 305 prot., datë 17.01.2017 “Mbi caktimin e personit përgjegjës për sistemin RENJK” nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, kërkohet specifikimi i personit përgjegjës për hedhjen e të dhënave dhe përdorimin e sistemit, çka provon funksionimin e sistemit në një periudhë të mëvonshme nga këto kërkime.
- Organi publik ka përditësuar vazhdimisht informacionin e publikuar në faqen zyrtare, kur ka patur zhvillime në lidhje me këtë projektligj deri në miratimin e tij.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar si dhe në zbatim të nenit 21/3 të Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në të cilin citohet “...Komisioneri kur e sheh të përshtatshme organizon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, me shkresën nr. 753/2 datë 05.06.2017 janë njoftuar përfaqësuesit e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe përfaqësuesit e

Ministrisë së Zhvillimit Urban për t'u paraqitur pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit me datë 14.06.2017 ora 10:00, për tu dëgjuar në lidhje me pretendimet e tyre.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesit e ankuesit/KSHH, i qëndruan pretendimeve të ngritura në ankesë.

Ankuesi pranoi faktin se organi publik/MZHU ka ndjekur hapa dhe procedura për konsultimin dhe marrjen e mendimeve të projektligjit, objekt i këtij procesi administrativ, por parashtroi se veprimet e kryera nuk janë realizuar në përputhje me procedurat e kërkuara nga ligji nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Ankuesi nisur nga parashtrimet e dhëna nga MZHU, se projektligji ka qëndruar 6 muaj në faqen zyrtare të këtij të fundit për konsultim (gusht e në vijim), përforcoi pretendimin e tij, se organi publik ka pasur mundësinë dhe kohën në dispozicion për të hedhur projektligjin në sistemin elektronik "*Regjistrin për njoftimet dhe konsultimet publike*", pasi ky i fundit është bërë funksional në muajin janar. Në fakt nuk ka rezultuar të jetë kryer ky veprim ligjor, pranuar kjo edhe nga organi publik në seancë dëgjimore. Ankuesi, në vijim edhe të pasqyrimin që është bërë në relacionin shpjegues dhe tabelën shoqëruese të projektaktit, pretendoi edhe mbi afatin një javor të cituar në publikim, për të konsultuar projektligjin, ndërsa, parashikimi ligjor kërkon minimalisht njoftimin dhe konsultimin e projektaktit për një afat 20 ditë dhe për projektakte që vlerësohen komplekse ky afat mund të dyfishohet.

Përfaqësuesit e organit publik paraqitën kopje të një e-maili ku i kërkohet mendim disa organizatave dhe subjekteve mes të cilëve edhe drejtorit ekzekutiv të KSHH, për draftin e parë të projektligjit në fjalë. Gjithashtu, paraqitën fotokopje shkresash ku jepen disa sugjerime dhe mendime nga institucione dhe organizata të ndryshme, madje përtej periudhës 6 mujore që projekt akti ka qëndruar në adresën zyrtare të organit publik.

Pas njohjes me pretendimet e ankuesit dhe organit publik, Komisioneri konstaton se organi publik ka ndërmarrë disa veprime konkrete për realizimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik të projektaktit, por ai nuk ka zbatuar procedurat e kërkuara nga ligji nr.146/2014 "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*". Fakti që Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) nuk ka qenë funksional në fazën fillestare të konsultimit të projekt aktit nuk duhet të pengonte organin publik që të publikonte atë në një moment të dytë (pas datës 17.01.2017), kur regjistri ka qenë funksional dhe projektligji vijonte të ishte ende në proces konsultimi.

Publikimi i projektligjit në Regjistër siç përcaktohet në nenin 6 të ligjit nr.146/2014 "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*", është ndër detyrimet kryesore të organit publik, ndërsa masat e ndërmarra nga organi publik/MZHU bëjnë pjesë në masa dytësore të përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr.146/2014, që organi publik i aplikon vetëm kur e shikon të nevojshme, por gjithmonë si masa plotësuese të publikimit në Regjistër.

Gjithashtu, përcaktimi i afatit një javor në tabelën shoqëruese të projektaktit të depozituar në Kuvend për të dërguar komente apo rekomandime, bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 15 të ligjit nr.146/2014 "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*".

Për sa më sipër, Komisioneri pasi analizoi faktet dhe provat e paraqitura nga palët në këtë proces administrativ, vlerëson se pretendimet e ankuesit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH), janë të bazuara në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës Nr. 256 Prot., datë 04.05.2017 të Komitetit Shqiptar të Helsinkit kundër Organit publik/Ministrisë së Zhvillimit Urban me objekt "Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftim dhe konsultim publik për projektligjin "Për strehimin social".
2. Konstatimin e moszbatimit nga organi publik/Ministria e Zhvillimit Urban, të procedurës së parashikuar në nenet 6, 7/1, 11 dhe 15/1 të Ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u shpall sot me datë 16.6.2017

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
